

VENDIM
Nr.236, datë 7.4.2010

**PËR DHËNIEN E FONDIT FINANCIAR INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË
QARKUT TË GJIROKASTRËS, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË FINANCUAR
NGA KOMISIONI EUROPIAN “REHABILITIMI I SISTEMIT UJITËS FUSHA E
DROPULLIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionit të prefektit të qarkut të Gjirokastrës t’i jepet fondi 2 508 700 (dy milionë e pesëqind e tetë mijë e shtatëqind) lekë, i barasvlershëm me 20 900 euro, që do të përdoret si kontribut i palës shqiptare, në masën 10 për qind të vlerës së përgjithshme, prej 209 000 eurosh, të bashkëfinancimit me Komisionin Europian, për zbatimin e projektit “Rehabilitimi i sistemit ujitës Fusha e Dropullit”, sipas kontratës nr.143-178, datë 10.8.2007, të nënshkruar nga palët.

2. Fondi prej 2 508 700 (dy milionë e pesëqind e tetë mijë e shtatëqind) lekë të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshme, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe prefekti i qarkut Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha